



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4881 Prot.

Roskovec, më 01, 07, 2024

VENDIM

NR 39. DATË 28.06. 2024

PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, përkatësisht neni 9 pika 1.7 gërma a), neni 54 pika m); të Ligjit Nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" neni 8, neni 9 pika 1, neni 11 pika 2, neni 13; VKM-së Nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medalieve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë"; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin për Dhënien e Titullit "Qytetar Nderi" të Bashkisë Roskovec, si më poshtë:
 - a) **Thanas Goga**, njihet për fushën e inxhinierisë në minierën e bakrit si dhe Kryetar i organizimit të punës dhe pagave në Drejtorinë e Përgjithshme të Industrisë së Bakrit.
 - b) **Zylyftar Xhaxho**, njihet për kontributin e dhënë prej 32 vitesh në Ndërmarrjen Sizmike, marrëdhëniet e ngushta që krijoi me miq dhe kolegë.
 - c) **Kozma Apostoli**, është dalluar si nxënës shumë i mire në Teknikumin Bujqësor, në Filialin e Universitetit të Tiranës në Fier, për degën Matematikë dhe Fizikë dhe vazhdoi studimet natën për katër vjet. Njihet për përkushtim ndaj çdo detyre të dhënë të kryera me devotshmëri si dhe ndershmëri.
 - d) **Bashkim Çepele**, është dalluar falë aftësive të tij të punës së përkushtuar dhe respektit të fituar me dinjitet ku ka qenë në poste drejtuese, brigadier, teknik sektori ,Përgjegjës i Sektorit të Investimeve (Ndërtimit) në NB Roskovec.Njihet si një nga drejtuesit e ndërtuesve Roskovecar që dhanë kontributin për Rindërtimin e zonave të prekura nga tërmeti i 15 Prillit 1978 në Shkodër.

e) **Aleksandër Jorgaqi**, rrjedh nga një familje juristi patriot (Vasil Jorgaqi) emrin e të cilit e mban një rrugë në lagjen Kastriot Fier. Është dekoruar me Medalje Pune dhe Urdhër Pune dhe për aftësi dhe punë të mire është dërguar në Hollandë me shërbim. Njihet si një nga personat që arritën të bëjnë Fermën e tyre Shkollë të Republikës për prodhimin e mishit.

2. Ngarkohet Komisioni Këshillimor për dhënien e titujve vendor të nderit, për kryerjen e procedurave përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

